



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

URDHËR

Nr. 192, datë 4.8.2006

PËR

PËRGATITJEN E PLANEVE TË INTEGRUARA TË MINISTRIVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i sistemit të planifikimit të integruar të Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave,

URDHËROJ:


1. Hartimin, nga çdo ministri, të Planit të Integruar të Ministrisë (PIM), si një produkt kryesor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), miratur nga Komiteti Ndërministror i Planifikimit Strategjik (KNPS), më 14.3.2006.
2. Plani i Integruar i Ministrisë (PIM), bazuar në Planin Buxhetor Afatmesme, do të jetë dokumenti përmbledhës, që paraqet veprimtaritë ministrore, të parashikuara për vitin në vijim, që mbështeten me fondet e disponueshme, buxhetore.

Gjithashtu, PIM-i do të shërbejë për përgatitjen e Raportit Vjetor të Progresit, për realizimin e krahasimeve të rezultateve ekzistuese me rezultatet e pritshme, të paraqitura në PIM, si dhe për informimin e institucioneve shtetërore dhe të opinionit publik.

3. Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të strukturës së PIM-it, të zbatohen udhëzimet, që i bashkëlidhen këtij urdhri.
4. Plani i Integruar i Ministrisë (PIM), për këtë vit, i nënshkruar nga ministri përkatës, të dërgohet për miratim në kabinetin e Kryeministrit, brenda muajit tetor, ndërsa për vitin 2007 e në vazhdim, të dërgohet brenda muajit qershor.
5. Miratimi përfundimtar dhe publikimi i Planit të Integruar të Ministrisë (PIM) të bëhet pas miratimit të buxhetit në Kuvend.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA